



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:040016

Datë: 02.10.2024

Numri i dokumentit: 06242941

C.nr.42/2023

Gjykata Themelore Gjakovë – Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Liman Javori në çështjen juridike të paditësve V.H.S.Htë punësuar në SHFMU “Petro Nino Luarasi” në fshatin L., Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim e përfaqëson Av. Zahir Hamza Rr.”Garibaldi”, Nr.13/8,10000, Prishtinë, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, jashtë seancës gjyqësore, me datën 02.10.2024 muar këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve V.H.S.Htë punësuar në SHFMU “Petro Nino Luarasi” në fshatin L., Komuna e Malishevës.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, që në emër të kompensimit të shujtave, t’ia paguaj paditësve si në vijim:

Paditësit **V.H.** në emër të shujtës ditore të përlllogaritur për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022 gjithsejtë 185 ditë pune t’ia paguaj nga dy euro në ditë, në shumën prej **370.00** euro,

Paditësit **S.H.** në emër të shujtës ditore të përlllogaritur për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022 gjithsejtë 185 ditë pune t’ia paguaj nga dy euro në ditë, në shumën prej **370.00** euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 09.02.2023, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësve t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 208.00 euro, dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësit V.H.S.Htë punësuar në SHFMU “Petro Nino Luarasi” në fshatin L., Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Zahir Hamza Rr.”Garibaldi”, Nr.13/8,10000 Prishtinë, në këtë gjykate kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë paditësve u takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2022 nga dy euro në ditë për secilin paditës për çdo ditë pune, gjykatës i kanë propozuar që të aprovojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, ashtu që të obligohet e paditura që paditësit V.H.t’ia paguaj për 185 ditë pune shumë prej 370.00 euro, paditësit S.H.t’ia paguaj për 185 ditë pune shumë prej 370.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% në vit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për parashtrimin e padis shumë prej 208 euro, dhe në emër të taksës shumë prej 20 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësve e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar se e njoftojmë gjykatën se ne i kemi marrë të gjitha shkresat e lëndës, dhe e kontestojmë padinë e paditësve duke e konsideruar si kërkesë plotësisht të pa bazuar në fakte dhe gjendjen faktike, e kontestojmë vlerën e borgjit lidhur me këtë çështje, sepse në këtë rast kemi të bëjmë me parashkrim të borgjit pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi pasi që palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me dt; 21.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate po ashtu në përgjigje në padi, e paditura e ka kontestuar edhe afatin ligjor të paraqitjes së padisë, duke konstatuar se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor, gjykatës i ka propozuar të refuzojë padinë e paditësve si të pa bazuar, ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës-MASHT.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: për paditësin V.H.Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.25/2023, të dt. 26.01.2023, Kontratën e punës me nr.11/166, të dt.08.03.2018, për paditësin S.H.Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.23/2023, të dt.26.01.2023, Kontratën e punës me nr.11/147, të dt.01.10.2020.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, ndërsa e aprovoj në tërësi për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, ndërsa kontestuese rezulton të jetë drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij Aktgjykimi, gjë për cilën e paditura e ka

pohuar këtë të drejtë të tyre, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 35 par.7 në të cilën përcaktohet se **“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”**, kjo gjykatë vlerëson se paditësve i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore gjatë punës për ditët e pranisë në punë përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas neni 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e neni 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e neni 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpenzimeve të shujtave u vendos që të njëjtën t’u aprovojë sipas periudhës për vitin 2021 gjatë të cilës paditësit kanë punuar tek e paditura fakt ky që u vërtetua edhe nga vërtetimet e lartcekura, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditësve t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, por gjykata pretendimet e e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësja padinë e ka parashtruar në periudhën në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja padinë e ka parashtruar në të njëjtën periudhë që përkon me kontratën kolektive të vitit 2017 dhe të vitit 2021, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet**

e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësja sipas padisë kërkonë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (09.02.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 208.00 euro, dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152, dhe 398 të LPK-së, si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.42/2023 me datën 02.10.2024

Gj y q t a r i
Nehat Qelaj

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.